



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh. II.nr.1573/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit “GLOBI-M.I.” Sh.p.k., me NUI:81011009, me seli në Ferizaj, rruga “Idriz Seferi”, kundër debitorit “Komuna e Kamenicës”, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Avokat Fatos Zeqiri nga Prishtina, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.1126/22 të datës 19.09.2023, me datë 11.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit “Komuna e Kamenicës”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.1126/22 të datës 19.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.1126/22 të datës 19.09.2023, ku në pikën I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Komuna e Kamenicës”, ashtu që ka anuluar pjesërisht Urdhrin Përmbartimor P.nr.375/21 të datës 01.11.2021 i Përmbartuesit Privat Kushtrim Musa, për pjesën e detyrimit në shumën prej 59,320.00 €. Në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Komuna e Kamenicës”, ashtu që pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.375/21 të datës 01.11.2021 i Përmbartuesit Privat Kushtrim Musa, për pjesën e detyrimit në shumën prej 11,394.10 € ka mbet në fuqi. Ndërsa në pikën III të dispozitivit është përfunduar pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit “GLOBI-

M.I.” Sh.p.k., ndaj debitorit “Komuna e Kamenicës”, sipas urdhrit P.nr.375/21 të datës 01.11.2021 i Përmbauesit Privat Kushtrim Musa, për pjesën e detyrimit në shumën prej 59,320.00 €.

Përgjigje në ankesë ka paraqit kreditori me propozim që të refuzohet ankesa e debitorit dhe të vërtetohet aktvendimi i ankimuar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloj aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr.1126/22 të datës 19.09.2023 dhe çështja kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “GLOBI-M.I.” Sh.p.k., me dt. 29.10.2021, ka paraqitur propozim për përmbaimit në bazë të dokumentit të besueshëm – Fatura nr.88/2021 e datës 27.08.2021; ku e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri t’ia paguaj borxhin total kreditorit në shumë prej 70,694.10 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data e arritjes së kërkesës për pagesë si dhe shpenzimet e procedurës përmbaimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbaimit me dhunë.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbaimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim në të cilin ka deklaruar fatura e bashkangjitur në propozim nuk i përmban elementet e domosdoshme për t’u konsideruar dokument i besueshëm. Ka shtuar se fatura nuk është dorëzuar dhe pranuar në mënyrë të rregullt prandaj nuk ka tipare të përmbaueshmërisë, fatura nuk është nënshkruar nga debitori dhe nuk është e vëlosur nga kreditori. Pos tjerash i ka propozuar Gjykatës ta aprovoj prapësimin, anuloj urdhrin përmbaimit si dhe të detyrohet kreditori që t’i mbuloj të gjitha shpenzimet e procedurës përfshirë edhe shpërblimin e avokatit për përpilimin e prapësimin.

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, ndër të tjera ka kundërshtuar pretendimet e debitorit ngase fatura i përmban të gjitha elementet e nevojshme sipas LPP-së e po ashtu e njëjta është pranuar nga debitori. Po ashtu ka shtuar se debitori nuk e ka kundërshtuar borxhin dhe ka përmbushur një pjesë të borxhit në shumën prej 59,320.00 € prandaj kreditori heq dorë nga kjo shumë dhe kërkon që procedura përbarimore të vazhdoj për pjesën e pa paguar në vlerë prej 11,394.10 €. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar Gjykatës ta refuzoj prapësimin dhe urdhrin ta vërtetoj si të bazuar.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1126/22 të datës 19.09.2023, ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Komuna e Kamenicës”, ashtu që ka anuluar pjesërisht Urdhrin Përbarimor P.nr.375/21 të datës 01.11.2021 i Përmbauesit Privat Kushtrim Musa, për pjesën e detyrimit në shumën prej 59,320.00 €. Në pikën II të dispozitivit ka refuzuar pjesërisht prapësimin e debitorit “Komuna e Kamenicës”, ashtu që pjesa tjetër e Urdhrit Përbarimor P.nr.375/21 të datës 01.11.2021 i Përmbauesit Privat Kushtrim Musa, për pjesën e detyrimit në shumën prej 11,394.10 € ka mbet në fuqi. Ndërsa në pikën III të dispozitivit është përfunduar pjesërisht procedura përbarimore e kreditorit “GLOBI-M.I.” Sh.p.k., ndaj debitorit “Komuna e Kamenicës”, sipas urdhrin P.nr.375/21 të datës 01.11.2021 i Përmbauesit Privat Kushtrim Musa, për pjesën e detyrimit në shumën prej 59,320.00 €.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përbarim dhe i lejuar me urdhrin e Përmbauesit Privat Kushtrim Musa është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit në vlerë prej 59,320.00 €, fakt ky që vërtetohet nga transferi bankar i datës 03.11.2021 i cili gjendet në shkresat e lëndës, e cila pagesë është pohuar edhe nga ana e kreditorit. Gjykata vendosi sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi urdhrin e përmbauesit privat P.nr.375/21 të datës 01.11.2021, për pjesën tjetër të detyrimit në shumën prej 11,394.10 € për faktin se debitori një pjesë të obligimit e ka përmbushur në shumën prej 59,320.00 € e cila vërteton njoftimin e debitorit për faturat e lartcekura dhe pranimin e borxhit nga ana e debitorit prandaj rezulton edhe kryerja e pagesës së pjesshme.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës se lëshuar nga kreditori, e cila faturë përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshme për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes se detyrimit monetar”*. Andaj, Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkallës së dytë, konsideron se fatura si dokument në sajë të cilës kreditori kërkon përmbartjen e detyrimit nga debitori, është e pranuar nga debitori sepse në shkresat e lëndës pranimi i faturës nga ana e debitorit vërtetohet nga shkresa me numër protokollit 1098 e datës 06.09.2021, në të cilën shkresë konstatohet se debitori e ka pranuar faturën më datën 06.09.2021, andaj pranimi i së njëjtës nënkupton që debitori ka pranuar detyrimin që buron nga fatura andaj edhe konsiderohet si dokument i besueshëm.

Po ashtu, Gjykata e Shkallës së Dytë vlerëson se bazuar në shkresat e lëndës gjeti se borxhi i kërkuar është përmbartur pjesërisht nga ana e debitorit në vlerë prej 59,320.00 €, fakt ky që vërtetohet nga transferi bankar i datës 03.11.2021 i cili përmban numrin e faturës 88/2021, e cila pagesë është pohuar edhe nga ana e kreditorit. Ndërsa debitori është i detyruar për pjesën e mbetur

të pagesës në vlerë prej 11,394.10 € si në pikën II të dispozitivit. Kështu, gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Gjykata vlerësoi pretendimet ankimore të debitorit lidhur me at se fatura nuk është e nënshkruar por e refuzoj si të pa bazuar sepse e njëjta është e pranuar me vul të protokulimit nga debitori. Kështu fatura në fjalë është e pranuar nga debitori dhe se e njëjta është përmbushë 83.9% e shumës së kërkuar ka mbet vetëm 16.1% pa u përmbush së shumës së kërkuar, pra ky fakt tregon se fatura është pranuar si e ligjshme është përmbush deri në 83.9% shumës së saj. Andaj nga të cekurat me lartë kjo gjykatë vlerësoi se pretendimet e debitorit mbetën vetëm të natyrës deklarative dhe si të tilla edhe i refuzoi si të pabazuara dhe se nuk kishin ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje përmbarimore dhe si të tilla i refuzoj ndërsa aktvendimin e ankimuar e vërtetoj.

Përndryshe në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë

K.Dh.Sh. II.nr. 1573/23, datës 11.04.2024

Gjyqtarja,

Franciska Zhitija Ymeri